



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr.08-271

09.10.2024

Shkup

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele në bazë të nenit 13 paragrafi (3), neni 18 paragrafi (1) nënparagrafi 1 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 69 paragrafët (1) dhe (4), neni 70 paragrafët 1, 4, 6, 9, 10, 11 dhe 12, neni 71, neni 74, neni 79, neni 80 dhe neni 81 nga Ligji i njëjtë, neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 1, neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 dhe neni 51 paragrafi (1) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, dhe në lidhje me Raportin me shkrim për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal në zonën e Manastirit nga pala e interesuar, personi juridik Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime eksport-import KAMAJ MEDIA SHPKNJP Manastir (nr.yinë ark.0803-680/1 datë 09.02.2024) me plotësim (ark.nr.08-680/7 datë 27.06.2024) Përgjigjes së Agjencisë për Komunikime Elektronike, ark.nr.0805-626/2 datë 28.02.2024 (nr.yinë ark.0803-680/5 datë 04.03.2024), Studimi për përcaktimin e arsytimit për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Manastirit (ark.nr.03-3935/1 datë 25.09.2024) dhe Konkluzionin ark.nr.02-4118/2 datë 09.10.2024, të seancën së 38-të mbajtur më 09.10.2024, miratoi si vijon:

V E N D I M

**për shpallje të konkursit publik për dhënien e
lejes për transmetim në radio të shërbimit programor
në nivel lokal**

1. Shpallet konkursi publik për dhënien e 1 (një) leje për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Manastirit, dhe atë për shërbimin programor radio folëse me format të përgjithshëm në të cilin llojet e programeve të përfaqësuara realizojnë së paku dy nga tre funksionet mediatike, në gjuhën maqedonase, e cila do të transmetohet përmes radio frekuencës së përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike (AKE), përkatësisht: 100.5 MHz.

2. Leja jepet për një periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh dhe nuk mund t'i transferohet një personi tjetër.

3. Kandidatët për konkurs duhet t'i përmbushin kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike, të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3953/1 datë 31.10.2023, të cilat shpjegohen dhe specifikon në dokumentacionin e Konkursit.

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 janë fshirë, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.248/18).

4. Karakteristikat teknike dhe parametrat e përcaktuar nga AKE në pajtim me Ligjin për Komunikime Elektronike ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.39/14, 188/14, 44/15, 193/15, 11/18 dhe 21/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr.98/19, 153/19 dhe 92/21) dhe rregulloret e miratuara në bazë të Ligjin, shpjegohen dhe specifikohen në dokumentacionin e Konkursit dhe miratimin për shfrytëzimin e radio frekuencave të dhënë nga AKE.

5. Aplikimet e paraqitura në konkurs, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) do t'i vlerëson në bazë të kritereve të mëposhtme, sipas metodës së mëposhtme të pikëzimit:

1. Përfaqësimi i programit të prodhuar nga vetë transmetuesi (in-house production), gjatë javës		17 pikë
<ul style="list-style-type: none"> deri në 50% të pjesës folëse të programit 	10 pikë	
<ul style="list-style-type: none"> mbi 50% të pjesës folëse të programit 	17 pikë	
2. Cilësia, zhanri dhe diversiteti tematik i përmbajtjeve		17 pikë
<ul style="list-style-type: none"> nga 3 deri në 5 lloje programesh në pjesën folëse të programit 	10 pikë	
<ul style="list-style-type: none"> mbi 5 lloje programesh në pjesën folëse të programit 	17 pikë	
3. Përfaqësimi në programe që nxisin zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare		17 pikë
<ul style="list-style-type: none"> programe që nxisin zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare, të transmetuara çdo vit 		
<ul style="list-style-type: none"> deri në 15 orë gjatë vitit 	5 pikë	
<ul style="list-style-type: none"> mbi 15 orë gjatë vitit 	9 pikë	
<ul style="list-style-type: none"> muzikë instrumentale nga autorë maqedonas dhe muzikë vokale dhe/ose vokalo-instrumentale në gjuhën maqedonase që transmetohet gjatë ditës 		
<ul style="list-style-type: none"> deri në 30% e totalit të muzikës së transmetuar 	5 pikë	
<ul style="list-style-type: none"> mbi 30% e totalit të muzikës së transmetuar 	8 pikë	
4. Përfaqësimi i informacionit dhe përmbajtjes në pjesën folëse të programit me rëndësi për zonën në të cilën do të transmetohet shërbimi programor (informacion me karakter lokal), gjatë javës		10 pikë
<ul style="list-style-type: none"> nga 3 deri në 5 orë të pjesës folëse të programit 	5 pikë	

<ul style="list-style-type: none"> • mbi 5 orë të pjesës folëse të programit 	10 pikë	
5. Numri dhe struktura e të punësuarve të nevojshëm për kryerjen e veprimtarisë (së paku 2 (dy) persona pjesëmarrës në krijimin e programit, të punësuar në marrëdhënie të rregullt pune me orar të plotë pune)		7 pikë
<ul style="list-style-type: none"> • deri në 2 punonjës 	5 pikë	
<ul style="list-style-type: none"> • mbi 2 punonjës 	7 pikë	
6. Kushtet teknike për prodhimin e programeve		7 pikë
7. Koha e ofruar e programit të transmetimit ditor		7 pikë
<ul style="list-style-type: none"> • nga ora 10 deri në orën 17 	4 pikë	
<ul style="list-style-type: none"> • mbi 17 orë 	7 pikë	
8. Kushtet hapësinore për kryerjen e veprimtarisë		7 pikë
9. Garancit e ofruara për aftësinë financiare për kryerjen e veprimtarisë		7 pikë
10. Afati i ofruar për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë		4 pikë
<ul style="list-style-type: none"> • deri në 3 muaj nga dita e dhënies së lejes 	4 pikë	
<ul style="list-style-type: none"> • mbi 3 muaj nga ditën e dhënies së lejes 	2 pikë	
	Në total	100 pikë

6. Për lejen për transmetim në radio paguhet kompensin vjetor për çdo vit aktual, duke filluar nga data e dhënies së lejes, në llogari të Agjencisë, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia.

Mënyra e llogaritjes, faturimit dhe pagesës së kompensimit për lejen, përcaktohet nga Agjencia në pajtim me nenin 80 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe në pajtim me Rregulloren për procedurat e punës financiare dhe kontabël të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 185/14), Rregulloren për formatet e shërbimeve programore të transmetuesve ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.172/14) dhe Rregulloren për zonat e transmetimit të shërbimeve televizive dhe radio ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.172/14).

7. Për shfrytëzimin e radio frekuencave paguhet kompensim vjetor në pajtim me Ligjin për Komunikime Elektronike dhe Rregulloren për mënyrën e llogaritjes së kompensimit vjetor për shfrytëzimin e radio frekuencave të AKE ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.192/21).

Kompensim për shfrytëzimin e radio frekuencave paguhet në llogari të AKE për çdo vit aktual paraprakisht duke filluar nga data e vlefshmërisë së miratimit për shfrytëzim të radio frekuencave.

8. Për përcaktimin e frekuencës së transmetimit, mikrolokacionit, fuqinë maksimale efektive të rrezatimit (ERP), drejtimin e sistemit të antenës, si dhe për parametra të tjerë teknikë që nuk përcaktohen me këtë Vendim dhe nga dokumentacioni i konkursit, kandidatët janë të detyruar (pasi të marrin dokumentacionin nga Agjencia dhe marrjen e konfirmimit nga Agjencia për dokumentacionin e tërhequr) duhet t'i drejtohet AKE, ku do të marrin parametrat teknikë të detajuar, të cilat janë pjesë përbërëse e dokumentacionit të konkursit dhe sipas të cilit do të duhet të përgatitet raporti teknik për pjesën e transmetimit.

Aplikimet e kandidatëve në AKE duhet të jetë me të njëjtin titull si në Agjenci.

9. Kandidatët në Konkurs dorëzojnë aplikime në formular të veçantë, ku formën dhe përmbajtjen e përcakton Agjencia, i cili publikohet në ueb faqen e Agjencisë.

Dokumentacioni i konkursit dhe formulari- Aplikimi për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Manastirit, mund të merret në arkivin e Agjencisë, Pallati "Panko Brashnarov", rr."Makedonija" nr.38, Shkup, çdo ditë pune nga ora 8:00 deri në orën 16:00.

Për dokumentacionin paguhet kompensim në shumë prej 60.000,00 (gjashtëdhjetë mijë) denarë në xhiro llogarinë: 300000000618023 e Agjencisë, Banka depozituese: Banka Komerciale SHA Shkup.

10. Aplikacioni dorëzohet në zarf të mbyllur në Agjenci, Pallati "Panko Brashnarov", rr."Makedonija" nr.38, Shkup, shënuar si në vijim², përkatësisht:

- në këndin e sipërm majtas të zarfit të mbyllur duhet të shënohet "MOS HAP" ,
- në mes të zarfit të mbyllur duhet të shënohet "Aplikim për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Manastirit".

Formularët dhe Shtojcat në Aplikimin për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Manastirit, duhet të sistemohen sipas rendit dhe numrit rendor të formularit, gjegjësisht si shtojcë në aplikacion, ku për çdo shtojcë të aplikacionit në faqen e parë në këndin e sipërm djathtas të fletës duhet të tregohet numrin serial përkatës (Shembull: Shtojcë nr. ____).

Aplikacioni me dokumentacionin shoqëruet nga neni 73 paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, dorëzohet në 2 (dy) kopje (origjinal dhe kopje).

11. Aplikacioni mund të dorëzohet me postë rekomanduese ose me dorëzim në arkivin e Agjencisë.

12. Aplikimi dorëzohet në afati prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh.

Afati për dorëzimin e aplikacioneve fillon nga dita e parë pas publikimit të këtij Vendimi në "Gazetën Zyrtare të RMV-së".

Aplikimet dorëzohen brenda afatit të përcaktuar me këtë Vendim në mënyrën, formën, numrin e kopjeve dhe me përmbajtjen e parashikuar në dokumentacionin e konkursit.

Aplikimet e kandidatëve që nuk do të paguajnë kompensimin për dokumentacionin, të cilat do të dorëzohen pas skadimit të afatit të përcaktuar me këtë Vendim, aplikimet e pa kompletuara (të cilat nuk do të përmbajnë të gjitha dokumentet dhe shtojcat sipas Aplikimit), aplikacionet e pa

² Nëse paraqitësit e aplikimeve për pjesëmarrje në konkurs publik nuk përmbushin kushtet e përcaktuara në pikën 10 të këtij Vendimi, Agjencia nuk merr përgjegjësi për vonesën ose hapjen e parakohshme të Aplikimit.

rregullta, si dhe aplikacionet që nuk do të dorëzohen në 2 (dy) kopje (origjinal dhe kopje), nuk do të shqyrtohen.

Informacion shtesë, në lidhje me konkursin e shpallur, mund të merren nga personat e mëposhtëm:

- për konceptin programor: mr. Ognen Nedelkovski telefon celular: 072/212-686 dhe e-mail adresë: o.nedelkovski@avmu.mk; Nesrin Mahmut telefon celular: 075/452-531 dhe e-mail adresë: n.sejfula@avmu.mk;

- për strukturën e pronësisë dhe kushtet kadrovike: Katerina Donevska telefon celular: 075/452-543 dhe e-mail adresë: k.mitre@avmu.mk;

- për kushtet teknike dhe hapësinore: mr. Argjend Xhelili telefon celular: 070/327-991 dhe e-mail adresë: argjend.xhelili@avmu.mk;

- për kushtet financiare: Vesna Simonovska telefon celular: 076/ 344-198 dhe e-mail adresë: v.simonovska@avmu.mk dhe

- për të dhëna të përgjithshme dhe çështje juridike: mr. Ivona Mufisheva telefon celular: 076/496-803 dhe e-mail adresë: i.mufiseva@avmu.mk dhe mr. Biljana Paneva-Parleeva, telefon celular: 076/344-194 dhe e-mail adresë: b.parleeva@avmu.mk.

13. Aplikimet që do të dorëzohen në këtë konkurs, do të hapen publikisht, në selinë e Agjencisë, Pallati, "Panko Brashnarov", rr." Makedonija" nr.38, Shkup, një javë pas skadimit të afatit për paraqitjen e aplikimeve, përcaktuar në pikën 12 të këtij Vendimi.

Informacioni për ditën dhe orën e hapjes publike do të publikohet në ueb faqen e Agjencisë: www.avmu.mk.

14. Vendimi për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Manastirit, në gjuhën maqedonase, do të miratohet në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e hapjes publike të aplikacioneve, e cekur në pikën 13 të këtij vendimi.

Kandidatët e konkursit do të njoftohen për vendimin për dhënien e lejes, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e miratimit të tij.

15. Ky vendim botohet në "Gazetën Zyrtare të RMV-së", dhe në ueb faqen e Agjencisë, dhe së paku në 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të RMV-së, dhe hyn në fuqi nga dita e botimit në " Gazetën Zyrtare të RMV-së".

A r s y e t i m

Drejtuar Agjencisë me datë 09.02.2024, është dorëzuar Kërkesë me shkrim, nr.y në ark. 0803-680/1 datë 09.02.2024 nga pala e interesuar, personi juridik Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime eksport-import KAMAJ MEDIA SHPKNJP Manastir (në tekstin e mëtejme KAMAJ MEDIA Manastir), për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal në zonën e Manastirit.

Agjencia, në pajtim me nenin 70 paragrafi (4) të LSHMAAV, me datë 13.02.2024, me rastin e kërkesës në fjalë nga pala e interesuar iu drejtua me Shkresë - Kërkesë, nr.y në ark.0803-680/2 AKE me të cilin ka kërkuar informacion nëse ka frekuencë të lirë në zonën e qytetit të Manastirit, dhe nëse ka - edhe informacion për parametrat bazë teknike në bazë të të cilave do të hartohet zgjidhje teknike për transmetimin e programeve në radio.

Megjithatë, të nesërmen pas dorëzimit të kërkesës së Agjencisë në AKE, gjegjësisht më 14.02.2024, Kryetari i Kuvendit të RMV-së miratoi Vendim për shpalljen e zgjedhjeve për Kryetar të RMV-së, ark.nr.09-1168/1 dhe Aktvendim për shpalljen e zgjedhjeve për deputetë të RMV-së, ark.nr.09-1169/1, të datës 14.02.2024. ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.37/24), me të cilin është përcaktuar se zgjedhjet do të mbahen më 24 prill dhe 8 maj 2024. Në funksion të zgjedhjeve të shpallura në vitin 2024 dhe duke pasur parasysh se kërkesa në fjalë i referohej shpalljes së

konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor përmes burimi natyror të kufizuar - radiofrekuencës , Këshilli i Agjencisë në seancën e 7- të mbajtur më 28.02.2024, miratoi vendim, ark.nr.0201-1006/2 datë 28.02.2024 për ndërprerje të procedurës pas kërkesës në fjalë deri në përfundim të zgjedhjes për kryetar të RMV-së, deputetëve në Kuvendin e RMV-së dhe zgjedhjes së Qeverisë së RMV-së në vitin 2024, në pajtim me rezultatet e zgjedhjeve, pas së cilës ajo duhet të vazhdojë në pajtim me dispozitat e LSHMAAV. Agjencia e njoftoi parashtruesin e kërkesës për Konkluzionin e miratuar për ndërprerjen e procedurës, si dhe për veprimet e ndërmarra nga Agjencia sipas procedurës së paraparë në LSHMAAV, më 29.02.2024, me Njoftim (ark.nr.0803-680/4), shkresë e cila është pranuar nga KAMAJ MEDIA Manastir më 04.03.2024.

Me datë 04.03.2024 AKE drejtuar Agjencisë i dorëzoi përgjigje për kërkesë- informacion Agjencisë, nr.0805-626/2, datë 28.02.2024 (nr.y në ark.0803-680/5 datë 04.03.2024), se në lidhje me analizën teknike nga ana e Sektorit për radiokomunikacion, parametra bazë sipas së cilës duhet të përpilohet zgjidhje teknike për mbulimin e komunës së Manastirit janë si në vijim: Fuqia e rrezatuar efektive: 200 W; Frekuenca: 100.5 MHz dhe Vendndodhja e transmetuesit – Tumbë Kafe.

Duke qenë se sipas konkluzioneve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve ark.nr.08-2163/1 datë 11.05.2024 dhe ark.nr.10-3082/1 datë 30.05.2024 dhe Vendimin për zgjedhje të Qeverisë së RMV-së, ark.nr. 08-3127/1 datë 23.06.2024 (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr.132/24), zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare të RMV-së në 2024, kanë përfunduar zyrtarisht, me përfundimin e procesit zgjedhor janë krijuar kushtet për vazhdimin e procedurës, ku Agjencia me datë 24.06.2024 me Kërkesë për deklarim (nr.y në ark. 08-680/6) ka kërkuar nga parashtruesi i Kërkesës, si palë e interesuar, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, të deklarojë nëse janë ende të interesuar për marrjen e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal në zonën e qytetit të Manastirit, e cila u pranua nga KAMAJ MEDIA Manastir më 26.06.2024. Me datë 27.06.2024, në adresën elektronike zyrtare të Agjencisë: contact@avmu.mk pala e interesuar ka dorëzuar Përgjigje për kërkesën (nr.y në ark.08-680/7 datë 27.06.2024) se ende është i interesuar për marrjen e lejes për transmetim në radio.

Në nenin 70 paragrafi (4) të LSHMAAV, parashihet se nëse në pajtim me Planin për ndarjen dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave, konstatohet se ekzistojnë radio frekuenca të lira, Agjencia do të përgatisë studim që do të përcaktojë arsyetimin për shpalljen e konkursit publik, veçanërisht nga aspekti i përmbushjes së qëllimit të këtij ligji, si dhe nga aspekti i nevojave të publikut (audiencës).

Rrjedhimisht nga sa më sipër, Agjencia përgatiti një Studim për përcaktimin e arsyetimit për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Manastirit (nr.y në ark.03-3935/1 datë 25.09.2024), i cili është publikuar në ueb faqen e Agjencisë më 25.09.2024³ Studimi është përgatitur për të përcaktuar arsyetimin për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për radio lokale në zonën e komunës së Manastirit, si nga aspekti i përmbushjes së qëllimit të LSHMAAV si dhe nga aspekti i nevojave të publikut. Gjatë përgatitjes së këtij studimi, përveç ofertës mediatike ekzistuese dhe potencialit të tregut, Agjencia ka marrë parasysh edhe funksionin e rëndësishëm social të medias lokale, rëndësia e të cilit, mbi të gjitha u reflektua në ofrimin e informacionit për ngjarjet (zhvillimet) në kuadër të zonës që mbulojnë, si dhe për faktin se ata duhet të përfaqësojnë platformë ku do të ngrihen çështje të rëndësishme për problemet konkrete që hasin qytetarët në zonën përkatëse, do të zhvillohet debat i hapur për to dhe për mënyrat e tejkalimit të tyre, e cila duhet të çojë në përmirësim cilësor të kushteve të jetesës në atë zonë. Në zonën e komunës së Manastirit program transmetojnë dy stacione radio lokale, të dyja janë radio muzikore-folëse të formatit të përgjithshëm dhe gjatë një jave raportuan se do të transmetojnë vetëm nga dy orë përmbajtje programore që trajtojnë ngjarje, informacione dhe përmbajtje të tjera me rëndësi për zonën lokale. Analiza e ecurisë së tyre ekonomike në tre vitet e fundit tregoi se potenciali i tregut nuk është shfrytëzuar në mënyrë

³ <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2024/09/Studim-për-përcaktimin-e-arsyetimit-për-shpallje-konkurs-publik-për-radio-në-Manastir.pdf>

optimale. Përkundër faktit se Manastiri ka potencial publiku të konsiderueshëm dhe reklamues potencial, këto dy radio stacione tregojnë të ardhura më të ulëta se radiostacionet në komunat me potencial shumë më të vogël tregu. Gjetjet nga studimi në fjalë, treguan se ekziston arsyetimi për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal në zonën e komunës së Manastirit dhe atë për shërbim programor radio folëse me format të përgjithshëm në të cilin llojet e programeve të përfaqësuara realizojnë së paku dy nga tre funksionet mediatike

Rrjedhimisht nga shpjegimi i mësipërm, dhe duke pasur parasysh se në pajtim me Planin për dhënien dhe shfrytëzimin e radio frekuencave është konstatuar se ka frekuencë të lirë për komunën e Manastirit, dhe në pajtim me Studimin, ark.nr.03-3935/1 datë 25.09.2024 u konstatua arsyetimi për publikim të konkursit publik për dhënien e lejes për radio në nivel lokal, për zonën e komunës së Manastirit, në bazë të nenit 13 paragrafi (3), neni 18 paragrafi (1) nënparagrafi 1 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 69 paragrafët (1) dhe (4), neni 70 paragrafët 1, 4, 6, 9, 10, 11 dhe 12, neni 71, neni 74, neni 79, neni 80 dhe neni 81 nga Ligji i njëjtë, neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 1, neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 dhe neni 51 paragrafi (1) të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Konkluzionin ark.nr.02-4118/2 datë 09.10.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në seancën e 38-të mbajtur më 09.10.2024, miratoi Vendim si në dispozitiv, e cila do të botohet në "Gazetën Zyrtare të RMV-së", dhe në ueb faqen e Agjencisë, dhe së paku në 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarët të RMV-së, e cila hyn në fuqi nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare Gazeta të RMV-së".

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Zëvendës Kryetari i Këshillit,
Selver AJDINI**